



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	28.12.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedimca Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	7713/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1411/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demianëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1411/2023 të datës 14.11.2023 të grupit të ankuesve

ni të cilit më autorizim i përfaqëson ankuesi , me adresë banimi: Fshati Kushevicë, Komuna Podujevë, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.12.2023, mori këtë.

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.1411/2023 e datës 14.11.2023, e parashtruara nga ankuesi

Arsyetim

Ankuesit e përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi (tani e tutje referuar ankuesit), me datë 14.11.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjen A.nr.1411/2023, kundër mosveprimit të institucionit punëdhënës dhe Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me kërkesën e tyre për harmonizimin e koeficienteve të pagës të përcaktuar me shtojcën 14.4 të Ligjit nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill pretendojnë se Departamenti i Burimeve Njerëzore i Agjencisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik me rastin e përcaktimit të koeficienteve të pagave për ankuesit të punësuar në kuadër të Departamentit Meteorologjik të ASHNA-së, me arsyetimin se nuk janë pozicionuar përshtatshëm me përcaktimet ligjore duke u trajtuar në mënyrë jo të barabartë para ligjit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 24.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Agjencia e Shërbimeve të Navigimit Ajror, ndërsa Këshilli me datë 07.12.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6973/2023 të datës 14.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASHNA e datës 31.12.2018; Kërkesën e ankuesve të datës 18.10.2023 me e-mailin e bashkangjitur të dërguar nga ankuesit për G.B; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigje në kërkesë e datës 07.12.2023; Akt emërimit e ankuesit M.H me përkrahimin e detyrave të punës; Akt emërimit e ankuesit R.L me përkrahimin e detyrave të punës; Akt emërimit e ankuesit I.I me përkrahimin e detyrave të punës; Akt emërimit e ankuesit V.M me përkrahimin e detyrave të punës; Kontratën e punës së ankuesit A.K me përkrahimin e detyrave të punës; Kontratën e punës së ankuesit L.D me përkrahimin e detyrave të punës; Kontratën e punës së ankuesit M.F me përkrahimin e detyrave të punës; Kontratën e punës së ankuesit E.Xh me përkrahimin e detyrave të punës; Kontratën e punës së ankuesit B.D me përkrahimin e detyrave të punës; Kontratën e punës së ankuesit Q.Th me përkrahimin e detyrave të punës; Kontratën e punës së ankuesit P.S me përkrahimin e detyrave të punës; E-mailin e datës 28.09.2023 dërguar nga G.B për Sh.A me korrespondencën e bashkangjitur prej pesë (5) faqesh; Lista e të punësuarve në ASHNA; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 16.02.2023 me shifër Nr.04/128;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e palejuar*, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesit parashtrues të kësaj ankesë që të gjithë janë të punësuar në Agjencinë e Shërbimit të Navigimit Ajror, gjegjësisht ankuesi M.H sipas akt emërimit të datës 01.04.2017 mbanë pozitën e punës "Parashikues Meteorologjik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi R.L sipas akt emërimit të datës 01.04.2017 mbanë pozitën e punës "Mbikëqyrës për Klimatologji dhe Statistika Meteorologjike" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi I.I sipas akt emërimit të datës 01.04.2017 mbanë pozitën e punës "Parashikues Meteorologjik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi V.M sipas akt emërimit të datës 01.04.2017 mbanë pozitën e punës "Parashikues Meteorologjik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi A.K sipas kontratës së punës të datës 30.09.2022 mbanë pozitën e punës "Vrojtues Meteorologjik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi L.D sipas kontratës së punës të datës 30.09.2022 mbanë pozitën e punës "Vrojtues Meteorologjik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi M.F sipas kontratës së punës të datës 30.09.2022 mbanë pozitën e punës "Vrojtues Meteorologjik Aeronautik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi E.Xh sipas

kontratës së punës të datës 30.09.2022 mbanë pozitën e punës "Vrojtues Meteorologjik Aeronautik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi B.D sipas kontratës së punës të datës 30.09.2022 mbanë pozitën e punës "Vrojtues Meteorologjik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi Q.Th sipas kontratës së punës të datës 30.09.2022 mbanë pozitën e punës "Vrojtues Meteorologjik Aeronautik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik, ankuesi P.S sipas kontratës së punës të datës 30.09.2022 mbanë pozitën e punës "Vrojtues Meteorologjik Aeronautik" në kuadër të Departamentit Meteorologjik.

Duke marr për bazë përcaktimet e Rregullores për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASHNA të datës 31.12.2018, arrihet në konstatimin se ankuesit të punësuar në kuadër të Departamentit të Meteorologjisë sipas strukturës organizative të ASHNA-së hyjnë në kuadër të zyrtarëve që kryejnë shërbime operative në fushën e kontrollit dhe navigimit ajror, prandaj ndërlidhur me dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.3. zyrtaret/ët e Agjencisë së Aviacionit Civil dhe Agjencisë të Shërbimeve të Navigimit Ajror, që kryejnë shërbime operative në fushën e kontrollit dhe navigimit ajror;" Kolegji i Këshillit konstatoi se për këtë kategori të punësuarve në Agjencinë e Shërbimit të Navigimit Ajror, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar ankesat e tyre pasi që të njëjtit kanë statusin e veçantë të nëpunësit civil.

Kolegji i Këshillit ka gjetur se ndërlidhur me veprimet procedural të ankuesve në funksion të realizimit të kërkesës së tyre të shprehur përmes pretendimeve ankimore, ka gjetur se ankuesit përpara se t'i drejtohen Këshilli me ankesë, të njëjtit me datë 18.10.2023 i janë drejtuar Njësisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror me kërkesën për pozicionim të koeficienteve të tyre sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik lidhur me shtojcën 14.4.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesve, ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj",* si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: "1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.* 4. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, konstaton se ankesa e ankuesve e datës 14.11.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që institucioni punëdhënës lidhur me kërkesën e ankuesve të datës 18.10.2023 ende nuk kishte vendosur apo nuk ka nxjerrë akt administrativ përpara se ankuesit të parashtrojnë ankesë në Këshill, sikurse që nuk është përmbushur as kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative, pasi që institucioni punëdhënës sipas dispozitave të lartcekura ligjore ka pasur afat kohor 45 (katërdhjetë e pesë) ditë për trajtimin e kërkesës së ankuesve të datës 18.10.2023, ndërsa ankuesit ankesën në Këshill e kanë parashtruar me datë 14.11.2023 apo 27 (njëzeteshtatë) ditë pas parashtrimit të ankesës në institucion punëdhënës.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimi de Vendosjen e Ankesave, nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesve e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 14.11.2022 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj është hedhur poshtë si e palejuar si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji."

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1411/2023

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve, .
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Shërbimit të Navigimit Ajror,
- Arkivit të KPMSHCK-së.